

MENDIM PAKICE

Unë gjyqtare Blerona Hasa, parashtroj mendimin tim në çështjen administrative Nr.5 Regjistri Dt.20.03.2023 Rregjistrimi, me:

PADITËSE: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari Z.Sali Berisha.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

PERSON I INTERESUAR: Partia Demokratike, përfaqësuar nga Kryetari Z.Lulzim Basha.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

- 1.Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të çregjistrojë subjektin “Partia Demokratike” e regjistruar me nënkryetarin, z.Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar;
- 2.Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari z.Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023;
- 3.Rregullimin e pasojave duke detyruar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të përfshijë subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari z.Sali Berisha si pjesë e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, koalicion i regjistruar nga KSHZ me vendimin e tij të datës 18.03.2023.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Blerona Hasa kryesuese/relatore, me anëtarë Alma Kolgjoka, Emona Muçi, Esmeralda Xhili dhe Manjola Xhaxho, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendosi me shumicë votash, rrëzimin e kërkespadsë.

Unë gjyqtare Blerona Hasa, parashtroj mendimin tim pjesërisht kundër, për shkaqet në vijim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet Vërtetimit **Dt.01.03.2023**, rezulton të ketë konfirmuar faktin se:

- me Urdhër Nr.12 Dt.19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë, është miratuar krijimi i Partisë “Partia Demokratike”, me iniciale “PD” ose “PDSH” dhe se
- kryetar i partisë është Z.Lulzim Basha.

Kryetari i Partisë Demokratike, Z.Lulzim Basha, rezulton të ketë dhënë dorëheqjen nga funksioni, më datë 21.03.2022.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë administruar **në emër të të njëjtit subjekt politik “Partia Demokratike”**:

- dy kërkesa (Nr.79 Dt.05.03.2023 (Nr.1329 Prot Dt.05.03.2023) nënshkruar nga Z.Sali Berisha dhe Nr.27 Dt.05.03.2023 (Nr.1337 Prot Dt.06.03.2023) nënshkruar nga Z.Indrit Sefa);
- me të njëjtin objekt, regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023;
- por me të dhëna të ndryshme në dokumentat shoqëruese lidhur me, emrin e kryetarit të partisë, të financierit dhe personit/personave përgjegjës për komunikim me KQZ-në.

Nga sa më sipër rezulton se, konflikti që i parashtrohet për zgjidhje Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor) ka lindur në kushtet kur, **të drejtën për t’u identifikuar me kryetarin e subjektit politik Partia Demokratike**, si kusht për të vënë në lëvizje Komisionerin me kërkesë për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor, **e ka pretenduar njëherësh, më shumë se një person**.

Konkretisht, të drejtën për t’u identifikuar me kryetarin e subjektit politik Partia Demokratike, Z.Sali Berisha e bazon në vendimmarrjet e Kuvendit Kombëtar të PD-së, dorëzuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, në gjykatën civile, për regjistrim.

Të qenurit e tij kryetar i PD-së e rrjedhimisht i vetmi person legjitim për të kërkuar regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, Z.Sali Berisha rezulton ta ketë pretenduar nga momenti i nënshkrimit të Kërkesës Nr.79 Dt.05.03.2023 (Nr.1329 Prot Dt.05.03.2023), deri në momentin e nënshkrimit të padisë me të cilën ka vënë në lëvizje Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Por, teksa gjatë procesit administrativ, njëri prej personave që e pretendon këtë të drejtë rezulton i pandryshueshëm (Z.Sali Berisha), personi tjetër që pretendohet se identifikohet me kryetarin e PD-se, sipas Z.Indrit Sefa, rezulton fillimisht Z.Lulzim Basha dhe më pas Z.Enkelejd Alibeaj.

Konkretisht, kërkesa për regjistrim Nr.27 Dt.05.03.2023 (Nr.1337 Prot Dt.06.03.2023), e nënshkruar nga Z.Indrit Sefa, ka objekt regjistrimin e Partisë Demokratike, me Kryetar Z.Lulzim Basha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të 14 Majit 2023.

Kërkesës rezulton t’i jenë bashkëngjitur:

- Vërtetimi Dt.01.03.2023 i Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Deklarata e angazhimit solemn;
- Autorizimi i Përgjithshëm Dt.18.03.2022.

Autorizimi i Përgjithshëm Dt.18.03.2022 rezulton i nënshkruar nga Z.Lulzim Basha në cilësinë e kryetarit të Partisë Demokratike dhe ka këtë përmbajtje:

“Unë, Lulzim Basha, me funksion Kryetar i Partisë Demokratike, lidhur me zgjedhjet vendore 2023, sipas datës së caktuar nga Dekreti i Presidentit të Republikës, në përmbushje të kompetencave të Kryetarit të Partisë, autorizoj ushtrimin e tyre nga Nënkryetari i Partisë

Z.Enkelejd Alibeaj dhe/ose Sekretari i Përgjithshëm Z.Gazmend Bardhi dhe/ose nga Sekretari për çështjet ligjore dhe zgjedhore Z.Indrit Sefa, lidhur me çështjet e mëposhtme:

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.10019/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me zgjedhjet vendore 2023, sipas datës së caktuar nga Dekreti i Presidentit të Republikës, **të autorizuarit** si më sipër, **kanë të drejtë, të gjithë sëbashku ose vec e vec:**

1. Të nëshkruajnë aktet për paraqitjen e kandidatëve...
2. Të nëshkruajnë deklaratën, në emër dhe për llogari të kryetarit të partisë, ku përmendet angazhimi solemn...
3. Të nëshkruajnë vetë ose të autorizojnë persona të tretë për të nëshkruar dokumentat për regjistrimin e Partisë Demokratike e Shqipërisë (PD) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve...
6. Të përmbushin cdo detyrim dhe përgjegjësi tjetër në zbatim të Kodit Zgjedhor.

Ky autorizim është i vlefshëm derisa të jetë ndryshuar, apo revokuar shprehimisht nga Kryetari i Partisë”.

Referuar përmbajtjes së Autorizimit të Përgjithshëm, rezulton që:

- Z.Indrit Sefa të ketë qenë një ndër tre personat e autorizuar nga Z.Lulzim Basha, për të nëshkruar dokumentat për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet vendore të vitit 2023 dhe të ketë nëshkruar në fakt, nën këtë cilësi (pra si i autorizuar), Kërkesën Nr.27 Dt.05.03.2023 (Nr.1337 Prot Dt.06.03.2023), për regjistrimin e PD-së në zgjedhjet vendore që do të mbahen më 14 Maj 2023;
- Z.Enkelejd Alibeaj të ketë qenë një ndër tre personat e autorizuar nga Z.Lulzim Basha, për të nëshkruar në emër dhe për llogari të këtij të fundit, deklaratën e angazhimit solemn. Nga Z.Enkelejd Alibeaj rezultojnë të jetë nëshkruar në fakt, në cilësinë e personit të autorizuar, Deklarata e Angazhimit Solemn e Kryetarit të Partisë Politike Dt.05.03.2023.

Konkretisht, në hyrje të Deklaratës së Angazhimit Solemn, evidentohet nga nënshkruesi i saj, fakti se:

“Në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), që sipas vërtetimit të datës 01.03.2023 të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka të regjistruar si Kryetar Z.Lulzim Basha, i cili ka lëshuar autorizimin e përgjithshëm të datës 18 Mars 2022, unë Enkelejd Alibeaj, deklaroj...”

Pra, referuar të dhënave të evidentuara në aktet e cituara më lart, më datë 05.03.2023, moment në të cilin rezultojnë të jetë dorëzuar në KQZ kërkesa për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, Z.Indrit Sefa dhe Z.Enkelejd Alibeaj nuk rezultojnë t’i kenë njohur vetes në raport me detyrimet zgjedhore, tjetër tagër veç atij për të vepruar si të autorizuar nga Z.Lulzim Basha.

Rrjedhimisht, më datë 05.03.2023, moment në të cilin rezulton të jetë dorëzuar në KQZ, kërkesa për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, Z.Indrit Sefa dhe Z.Enkelejd Alibeaj rezulton se:

- njohin zyrtarisht Z.Lulzim Basha, si kryetar të Partise Demokratike;
- kryejnë veprime për të cilat janë autorizuar shprehimisht nga kryetari i partisë, Z.Lulzim Basha;
- nuk bëjnë me dije drejtimin e Partisë Demokratike nga Z.Enkelejt Alibeaj, si kryetar i komanduar i partisë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton t'i ketë bashkuar në një shqyrtim të dyja kërkesat, duke disponuar në përfundim Vendimin Nr.158 Dt.09.03.2023, që konsiston në:

“1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, “Partisë Demokratike sipas arsytimit të këtij vendimi...”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë arsytuar se:

“I vetmi dokumentacion të cilin KQZ-ja (Komisioneri në këtë rast) ka detyrim t'i referohet mbi atë se kush është kryetari i PD-së është vërtetimi i Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kushtet kur sipas këtij dokumenti zyrtar, të lëshuar nga një institucion publik i ngarkuar me ligj për ta bërë këtë (gjykata), rezulton se kryetar i PD-së është z.Lulzim Basha, atëherë vetëm ky i fundit ka të drejtën të paraqesë kërkesë për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve legjitimon z.Lulzim Basha për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje...

Në rastin në fjalë z.Lulzim Basha ka autorizuar z.Enkelejd Alibeaj, z.Gazment Bardhi dhe z.Indrit Sefa që veçmas, ose të gjithë bashkë, krahas delegimeve të tjera që ka autorizimi përkatës, të paraqesin kërkesën për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, sipas datës së caktuar nga Presidenti me dekret...

3. Kërkesa e z. Lulzim Basha (nëpërmjet përfaqësuesit të PD-së në KQZ) për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 64, pika 2, gërma “e”.

Sipas kësaj pike, së bashku me dokumentet e kandidimit për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ “deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet”...

Nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë se ky detyrim për kryetarin e partisë nuk është i transferueshëm, apo i delegueshëm tek të tretët. Dispozita e përcakton qartë që deklarata është përgjegjësi e kryetarit të partisë. Si e tillë ajo nuk është e transferueshme. Deklarata është një akt individual i personit. Ajo nuk është kompetencë apo e drejtë e cila me këtë rast edhe mund të delegohej....Ndaj në konkluzion të analizës së fakteve dhe të dokumentacionit të sipërcituar duhet që të bëhet plotësimi i dokumentacionit bashkëshoqërues të kërkesës për regjistrim të partisë si subjekt zgjedhor”.

Në cilësinë e gjyqtarit të mbetur në pakicë çmoj të nevojshme të evidentoj faktin se, deri në këtë fazë të procesit, pra deri në kthimin për plotësim të kërkesës për regjistrim, Z.Enkelejd Alibeaj nuk rezulton t'i ketë njohur vetes funksion, duke mos e nënshkruar si nënkryetar i komanduar, Kërkesën Nr.27 Dt.05.03.2023, për regjistrimin e PD-së në zgjedhjet vendore.

Nga ana tjetër, as Z.Indrit Sefa, pra personi që vuri në lëvizje Komisionerin me kërkesë për regjistrimin e PD-së në zgjedhjet vendore, nuk rezulton të ketë identifikuar Z.Enkelejd Alibeaj, deri më datë 09.03.2023, si kryetar të komanduar të Partisë Demokratike.

Z.Indrit Sefa nuk rezulton ta ketë ankimuar në KAS, Vendimin Nr.158 Dt.09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por rezulton t'i jetë drejtuar një ditë më pas këtij të fundit, nëpërmjet Shkresës Nr.27/2 prot **Dt.10.03.2023** (protokolluar pranë KQZ me nr.1602 prot., datë 11.03.2023), duke i bërë me dije se:

“Është fakt i njohur botërisht dhe që nuk ka nevojë të provohet, se prej një kohe të gjate Partia Demokratike e Shqipërisë, partia më e madhe e opozitës, po kalon një periudhë konflikti të brendshëm, dhe në mungesë në detyrë të Kryetarit të Partisë. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e brendshme të funksionimit të Partisë Demokratike (konkretisht nenit 46 të Statutit të PDSH), që përcaktojnë se: “Kryetari i Partisë ndihmohet nga Nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm... Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkryetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin”, është lëshuar Autorizimi i Përgjithshëm datë 18 Mars 2022. Për shkak se dorëheqja e Kryetarit është fakt, edhe pse nuk është pasqyruar në regjistrin e partive politike, për shkak të moszgjedhjes së Kryetarit të ri të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në kuptim të ligjit nr.8580, date 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, funksionimi i Partisë Demokratike për aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet vendore realizohet sipas “Autorizimit të Përgjithshëm” të datës 18 Mars 2022.

Përsa më lart, në mbështetje të nenit 64 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke qenë se dokumentacioni i dërguar është i plotë dhe nisur nga fakti që është objektivisht dhe ligjërisht e pamundur mos zbatimi i Autorizimit të Përgjithshëm të datës 18 Mars 2022, kërkojmë shfuqizimin kryesisht të vendimit nr.158/2023 dhe vijimin e procedurës ligjore të regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 Majit 2023, duke mbajtur në konsideratë rrethanat ligjore dhe faktike si më sipër”.

Por, për herë të parë, 4 ditë më pas, Z.Indrit Sefa rezulton t'i ketë përcjellë Komisionerit, Shkresën Nr.27/3 prot. **Dt.14.03.2023**, duke bërë me dije nëpërmjet saj, se:

“Në vijim të shkresës sone nr.27/2 Prot., datë 10 Mars 2023, me anë të së cilës ju kemi informuar pamundësinë për të përmbushur kërkesat tuaja, për shkak se z.Basha nuk ndodhet faktikisht në detyrë, për shkak të heqjes dorë nga detyra në mënyrë publike, përpara Kryesisë së Partisë, më datë 21 Mars 2022, dëshirojmë tju sjellim në vëmendjen tuaj se funksionimi i Partisë Demokratike në mungesë të Kryetarit bëhet sipas rregullave të brendshme të Partisë.

Siç jeni në dijeni, përveçse është lëshuar Autorizimi i Përgjithshëm datë 18 Mars 2022, që garanton funksionimin normal të Partisë Demokratike për efekt të zgjedhjeve vendore, për shkak të moszgjedhjes së Kryetarit të ri të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në kuptim të ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, dhe nenit 46 të Statutit të Partisë Demokratike, Nënkryetari i zgjedhur nga Këshilli Kombëtar i PD dhe që është i vetmi në detyrë për këtë

përgjegjësi, Z.Enkelejd Alibeaj, është komanduar të drejtojë Partinë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri...

Në këtë kuptim, nënshkrimi prej tij i deklaratës së angazhimit solemn, është tërësisht i vlefshëm për tu konsideruar si marrje përsipër e përgjegjësisë formale, në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të afatit të caktuar për plotësimin e dokumentacionit, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.172 Dt.14.03.2023.

Edhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, rezulton t’i ketë bashkuar në një gjykim, dy kërkesat ankimore kundër Vendimit Nr.172 Dt.14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe konkretisht:

- Kërkesën Ankimore Nr.32 Dt.14.03.2023 të Partisë Demokratike të Shqipërisë, nënshkruar nga Z.Indrit Sefa;
- Kërkesën Ankimore Nr.33 Dt.15.03.2023, të Partisë Demokratike të Shqipërisë, nënshkruar nga Z.Sali Berisha.

Mbi ankesat e palës paditëse dhe palës së interesuar, kundër Vendimit Nr.172 Dt.14.03.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.27 Dt.16.03.2023, që konsiston në:

“1.Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.33 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri;

2.Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr.32 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa;

3.Ankuesi “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:

-deklaratën sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z.Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

-“deklaratën e angazhimit solemn” të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

4.Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë”.

Duke u bashkuar me shumicën sa i takon ligjshmërisë së Vendimit Nr.27 Dt.16.03.2023 të KAS, që ka rrëzuar kërkesën ankimore nr.33 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga Z.Ledio Nuraj dhe Z.Franci Nuri, ndaj tjetër qendrim lidhur me disponimet e KAS në pikat 2, 3 dhe 4 të vendimit.

Lidhur me këto pika, shumica ka argumentuar se:

“...pala paditëse Partia Demokratike, me kryetar z.Sali Berisha, sakohë që nuk përlligjet në regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimarrjen e KAS në lidhje me regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Ky parashikim ligjor përcakton se vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit

të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. Pra, pala paditëse në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor ka të drejtën të ankimojë vendim-marrjen për mosregjistrimin e saj si subjekt zgjedhor siç ka vepruar, kërkim që u rrëzua. Në këto kushte, kërkimin për ç' regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike përfaqësuar nga nënkryetari z. Enklejd Alibeaj, pala paditëse nuk legjitimohet t'a paraqes para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, sakohë që vet nuk është subjekt zgjedhor, që më tej t'i cenohen interesat nga vendim-marrja e KAS. Kriteria këto të parashikuara në nenin 145 të Kodit Zgjedhor që legjitimojnë palët paditëse para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Përkundër sa më sipër vlerësoj se, dy kërkesat ankimore që kanë vënë në lëvizje KAS-in, nuk i përkasin dy subjekteve politike/zgjedhore, çka do diktonte zbatimin e Nenit 145 të Kodit Zgjedhor, por, sikurse me të drejtë konkludon edhe KAS, janë kërkesa konkurruese që paraqiten në emër të të njëjtit subjekt.

Sikurse evidentova edhe më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë administruar në emër të të njëjtit subjekt politik “Partia Demokratike”:

- dy kërkesa (Nr.79 Dt.05.03.2023 (Nr.1329 Prot Dt.05.03.2023) nënshkruar nga Z.Sali Berisha dhe Nr.27 Dt.05.03.2023 (Nr.1337 Prot Dt.06.03.2023) nënshkruar nga Z.Indrit Sefa);
- me të njëjtin objekt, regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023;
- por me të dhëna të ndryshme në dokumentat shoqëruese lidhur me, emrin e kryetarit të partisë, të financierit dhe personit/personave përgjegjës për komunikim me KQZ-në.

Lidhur me çështjen e legjitimitimit, konfirmoj qendrimin e KAS, shprehur në Vendimin Nr.20 Dt.13.03.2023, sipas përfundimeve të të cilit:

“4.Vendimi i Komisionerit nr.158, datë 11.03.2023 ka urdhëruar “Partinë Demokratike” me kryetar z.Lulzim Basha që të bëjë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim, sipas porosive të Komisionerit. Tek ky urdhërim, “Partia Demokratike” me kryetar z.Sali Berisha nuk ka asnjë interes të ligjshëm. Nëse “Partia Demokratike” me kryetar z.Lulzim Basha duhet të urdhërohet që të plotësojë dokumentacionin ose jo, kjo është një çështje që prek vetëm interesat e ligjshme të kësaj të fundit. “Partia Demokratike” me kryetar z.Sali Berisha ka interes të ligjshëm në vendimarrjen e Komisionerit, nëse ai vendos të regjistrojë si subjekt në zgjedhje “Partinë Demokratike” me kryetar z.Lulzim Basha, ose nëse ai vendos të rrëzojë kërkesën e “Partisë Demokratike” me kryetar z.Sali Berisha për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor...”

Sikurse evidentohet edhe në vendimin e shumicës, Komisioneri ka refuzuar të regjistrojë si subjekt zgjedhor “Partinë Demokratike” me kryetar Z.Sali Berisha, çka legjitimonte këtë kërkesë të investonte KAS-in me ankim, ashtu sikurse legjitimohej edhe personi i tretë, të cilit gjithashtu i ishte refuzuar nga Komisioneri, kërkesa për regjistrim të Partisë Demokratike, me kryetar Z.Lulzim Basha.

Bazuar në këtë standard, Partia Demokratike me kryetar Z.Sali Berisha, legjitimohej të investonte KAS-in me ankim, nëse Komisioneri do të kishte disponuar me vendim për të regjistruar si subjekt në zgjedhje, “Partinë Demokratike” me kryetar z.Lulzim Basha, ashtu sikurse

legjitimohet të investojë Kolegjin Zgjedhor, në kushtet kur KAS, ndryshe nga Komisioneri, ka vendosur të regjistrojë në zgjedhje, “Partinë Demokratike” me kryetar z.Lulzim Basha.

KAS rezulton ta ketë bazuar vendimin objekt padie, ndër të tjera, në argumentin se:

“7.Për efekt të regjistrimit në zgjedhje, të dhënat identifikuese janë ato që deklarohet subjekti. Nëse midis tyre dhe të dhënave që përmban vërtetimi gjyqësor ka mospërputhje, atëherë KQZ-ja është e detyruar të hetojë se mos këto mospërputhje vijnë për shkak se ndodhemi përpara një subjekti me identitet tjetër, të ndryshëm nga ai që figuron i regjistruar në gjykatë, apo subjekti është i njejtë dhe të dhënat e vërtetimit gjyqësor janë të paazhornuara. Për të dhëna të paazhornuara, KQZ-ja nuk mund të vendosë përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet. Hetimi administrativ i Komisionerit në rastin e ankuesit të përfaqësuar nga z.Indrit Sefa provoi se mbajtja në regjistër e emrit të z.Lulzim Basha si kryetar i Partisë, kur ai ka dhënë dorëheqjen dhe është zëvendësuar në detyrë nga z.Enkelejd Alibeaj, përbën mosazhornim të regjistrimit dhe jo provë se në fakt kryetar i partisë vazhdon të jetë z.Basha...

8.Kur identiteti i subjektit të regjistruar në gjykatë është i ndryshëm nga ai i subjektit kërkues, atëherë KQZ-ja është e detyruar të saktësojë identitetin, përpara se të procedojë me pranimin ose rrëzimin e kërkesës. Kërkesa e paraqitur nga një subjekt impostor duhet të rrëzohet, kurse midis dy kërkesave konkurruese që paraqiten në emër të të njejtit subjekt, KQZ-ja duhet të pranojë për shqyrtim kërkesën që demonstroi tek vetja vazhdimësinë dhe vullnetin e subjektit. Ky vërtetim kërkon hetim dhe arsyetim juridik mbi provat. Vërtetimi nga regjistri i partisë është fillestë e hetimit, jo “prova mbretëreshë”.

17.Vazhdimësia institucionale nga Kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj provohet nga autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga Kryetari i PD-së z. Lulzim Basha më datë 18.03.2022, kur ishte në ushtrim të plotë të tagrave të veta, sikurse provohet nga shkresa e Sekretarit të PD për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore me nr.27/3 prot., datë 14.03.2023, protokolluar në KQZ me nr.1650 prot., datë 14.03.2023, nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.508 Regj.Them., datë 22.04.2022, si dhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr.44, datë 03.03.2023.

18.Prandaj Kryetari i komanduar i Partisë Demokratike z. Enkelejd Alibeaj ka tagra të plota të nënshkruajë, me këtë cilësi, kërkesën për regjistrim dhe gjithë dokumentacionin deklarativ që kërkon pika 2 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Ky dokumentacion duhet të jetë i azhornuar, pavarësisht se regjistri gjyqësor mund të mos jetë i tillë. Autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga z. Lulzim Basha e ka humbur fuqinë nga momenti që ai ka dhënë dorëheqjen dhe është zëvendësuar në detyrë nga Kryetari i komanduar i Partisë, z. Enkelejd Alibeaj dhe është i panevojshëm për procedurën e regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor”.

Duke konfirmuar faktin e të mosqenurit të Z.Lulzim Basha kryetar i Partisë Demokratike, për shkak të dorëheqjes së tij më datë 21.03.2022, e konsideroj të pabazuar në prova përfundimin e KAS se, Z.Lulzim Basha është zëvendësuar në detyrë nga z.Enkelejd Alibeaj.

KAS referon si provë që për ligj këtë përfundim, Shkresën Nr.27/3 prot. Dt.14.03.2023, e nënshkruar nga Z.Indrit Sefa.

Duke mos e konsideruar këtë shkresë si provë, e aq më pak si mbretëreshë të provave konfirmuese të vendimmarrjeve të organeve drejtuese të Partisë Demokratike, vlerësoj se, hetimi lidhur me këtë fakt lipsej kryer në raport me Nenin 46/4 të Statutit të Partisë Demokratike, që parashikon se:

“Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkyetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë rastet e dorëheqjes nga detyra të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon Nënkyetarin që do të drejtojë Partinë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjedhjen e Kryetarit të ri”.

Në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton se, Sekretari i Përgjithshëm i PD, mbledh Këshillin Kombëtar me qëllim komandimin e nënkryetarit për drejtimin e Partisë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjedhjen e Kryetarit të ri, në rastet kur:

- Kryetari i Partisë, edhe pse në rrethana mungese të gjatë, nuk ka lëshuar autorizim për njërin nga nënkryetarët e partisë;
- Kryetari i Partisë ka dhënë dorëheqjen.

Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike nuk rezulton të jetë mbledhur dhe të ketë komanduar nënkryetarin Enkelejd Alibeaj, drejtues të Partisë Demokratike.

Në këtë kontekst vlerësoj se, Autorizimi i Përgjithshëm Dt.18.03.2022 do të përligjte kryerje veprimesh nga tre personat e autorizuar: Z.Indrit Sefa, Z.Gazmend Bardhi dhe Z.Enkelejd Alibeaj, vetëm nëse zgjedhjet vendore do të ishin mbajtur nga dita e lëshimit të autorizimit, deri ditën e dorëheqjes së Z.Lulzim Basha, pra në periudhën kohore 3-ditore 18.03.2022-21.03.2022.

Në vlerësimin tim, Autorizimi i Përgjithshëm Dt.18.03.2022 ka humbur fuqinë, në kushtet kur:

- Zgjedhjet vendore janë vendosur me dekret, të mbahen pas datës 21.03.2022;
- Pas datës 21.03.2022, Z.Lulzim Basha ka pushur së ushtruar funksionin e kryetarit të Partisë Demokratike.

Rrjedhimisht, kalimi i Z.Alibeaj nga person i autorizuar nga Z.Lulzim Basha për të kryer veprime në kontekstin zgjedhor, në kryetar të komanduar të PD-së, përbën procedurë të kryer për herë të parë, nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Z.Indrit Sefa nuk rezulton ta ketë ankimuar vendimin e KAS, duke rënë rrjedhimisht dakord me faktin se, ndryshe nga sa ai vetë besonte deri më datë 10.03.2023 (kur nënshkroi shkresën Nr.27/2), Z.Alibeaj nuk ishte thjesht njëri nga tre personat e autorizuar nga Z.Lulzim Basha për kryerjen e procedurave për regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor, por kryetar i komanduar i Partisë Demokratike.

Në cilësinë e gjyqtarit të mbetur në pakicë vlerësoj se, KAS mund të dispononte me vendimin objekt ankimi, vetëm në rast se do të kishim të bënim me një gabim formal, në kuptimin që, kërkesa për regjistrim të ishte dorëzuar nga Z.Indrit Sefa, sipas autorizimit të lëshuar nga

Z.Lulzim Basha, në një kohë kur pas dorëheqjes së këtij të fundit, bazuar në Nenin 46 të Statutit të Partisë Demokratike, Këshilli Kombëtar të kishte disponuar me vendim mbi komandimin e nënkryetarit Enkelejd Alibeaj, për të drejtuar partinë, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Vetëm në një rast të tillë KAS kishte kompetencë të korrigjonte vendimmarrjen e Komisionerit, duke përligjur disponimin në vendimin objekt padie, sipas të cilit:

“3.Ankuesi “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa të depozitohet në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:

-deklaratën sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z.Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

-“deklaratën e angazhimit solemn” të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

4.Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;...”.

Mosvërtetimi i këtyre rrethanave, vlerësoj se përbënte pengesë absolute që KAS t’i hynte shqyrtimit për të analizuar dhe identifikuar në bazë të kësaj analize, personin që drejton Partinë Demokratike, pas dorëheqjes së Z.Lulzim Basha, duke identifikuar si të tillë Z.Enkelejd Alibeaj, krejtësisht në padijeni të këtij të fundit, fakt që konfirmohet me mosnënshkrimin prej tij që në krye të herës, të Kërkesës Nr.27 Dt.05.03.2023 (Nr.1337 Prot Dt.06.03.2023).

Duke mos përligjur sa më sipër, konfirmoj qendrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, evidentuar në Vendimin Nr.172 Dt.14.03.2023, se:

“(1).Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike rregullohet me ligjin nr.8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar. Sipas nenit 9 të këtij ligji “Regjistrimi i partive politike bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit...”

Në kuptim të kësaj dispozite i vetmi dokument zyrtar, i cili na jep të dhëna mbi emrin e kryetarit të partisë është regjistri i partive politike i Gjykatës së Rrethit Tiranë. Kështu nga vërtetimi i datës 1 Mars 2023 i lëshuar nga Zyra e këtij Regjistri rezulton se kryetar i Partisë Demokratike është z. Lulzim Basha...

Nga ana tjetër në kushtet kur pretendohet se kryetari i partisë ka dhënë dorëheqjen dhe funksionet e tij i kryen nënkryetari, a është më i vlefshëm ky autorizim?

(2). Neni 64 gërma “e” e Kodit Zgjedhor përcakton se për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ, krahas dokumenteve të tjerë edhe deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve, etj...

Përfaqësuesi i PD në KQZ, z.Sefa pretendoi se është fakt i njohur botërisht që prej marsit 2022 z.Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si kryetar i PD-së. Ndaj në këto kushte, sipas atij, nuk është e mundur që z.Basha të nënshkruajë Deklaratën Solemne.

Ky pretendim nuk ka asnjë bazë ligjore. Fakti që kryetari i partisë “nuk gjendet”, sepse ka dhënë dorëheqjen nuk përligj mos paraqitjen e Deklaratës sipas përcaktimit të ligjit.

E nga ana tjetër ky pretendim vjen në kontradiktë me veprimet/kërkimet konkrete të bëra nga të autorizuarit prej z. Lulzim Basha në kuadër të procesit të regjistrimit të PD si subjekt zgjedhor.

Kur është rasti për të legjitimuar kërkesën për regjistrim të PD si subjekt zgjedhor kundrejt pretendimit të z.Sali Berisha se është ai që ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor, nga i autorizuari prej z.Lulzim Basha dhe përfaqësues i PD në KQZ z. Sefa sillet si provë fakti juridik i pasqyruar në vërtetimin e Zyrës së Regjistrimit të partive Politike i gjykatës së rrethit Tiranë sipas të cilit ligjërish kryetar i PD është z. Lulzim Basha.

Kur u kërkohet që përderisa z. Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike dhe është ai që duhet të përmbushë të gjitha detyrimet që Kodi Zgjedhor i ngarkon atij posacërisht, atëhere sillet në vëmendje pretendimi se z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si kryetar dhe se ky është një fakt i njohur publik. E për këtë shkak, sipas pretenduesit nuk është e mundur që atij t'i merret nënshkrimi për Deklaratën Solemne. Sipas tij (z. Sefa) nënshkrimi i saj nga i autorizuari z.Enkelejd Alibeaj është në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

...kryetari i PD z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen që prej Marsit 2022.

Për vetë kryetarin (apo ish-kryetarin e PD z. Basha) nuk ka asnjë detyrim ligjor për ta formalizuar aktin e dorëheqjes e për më tepër për ta paraqitur atë përpara ndonjë institucioni publik. Ai është i përligjur në mos interesin e tij në lidhje me administrimin ligjor të aktit të dorëheqjes.

Por organet e tjera drejtuese të partisë, si nënkryetari, apo sekretari i përgjithshëm, apo kushdo tjetër që sipas statutit mendohet se mundet të marrë funksionet e kryetarit kur ai ka dhënë dorëheqjen, apo edhe një palë tjetër e interesuar (ndoshta edhe anëtari i partisë) do të duhej të depozitonin në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë njoftimin, sipas të cilit kryetari i PD z. Basha ka dhënë dorëheqjen, si dhe aktin sipas të cilit PD drejtohet tani nga nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj.

Si ligji për partitë politike, ashtu edhe Kodi Zgjedhor, apo edhe ndonjë ligj tjetër nuk e detyrojnë një parti politike që në kushtet kur kryetari ka dhënë dorëheqjen, të zgjedhin detyrimisht kryetarin e ri. Për arsye dhe interesa të vetat, partia mund të vendosë që ajo për një kohë, sipas përcaktimeve të statutit të saj, të drejtohet dhe të përfaqësohet nga nënkryetari, apo nga ndonjë organ tjetër i partisë. E në këtë rast ky organ ka të gjitha atributet e kryetarit dhe njihet edhe nga të tretët si i tillë, edhe pse formalisht nuk është kryetari i partisë.

Organet e tjera drejtuese të PD, pasi z. Basha dha dorëheqjen (sipas tyre) kanë patur rreth një vit kohë në dispozicion për të bërë depozitimet e akteve si më sipër përmëndur në Zyrën e Regjistrimit të partive politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vetëm kështu z.Alibeaj, si nënkryetar i PD do të kishte përfituar të gjitha kompetencat e kryetarit të PD duke mos qënë formalisht i tillë.

Në kushtet kur në Zyrën e Regjistrimit të partive politike të Gjykatës së Rrethit Tiranë nuk është bërë njoftimi i dorëheqjes së z.Lulzim Basha si kryetar, si dhe nuk është bërë depozitimi i aktit sipas të cilit (bazuar në statutin e PD), është z. Alibeaj ai që ushtron detyrën e kryetarit, atëhere ai si nënkryetar i PD mund të pranohet se i ushtron disa kompetenca, apo edhe pjesën më të madhe të kompetencave formale të kryetarit të PD, por nuk mund të pranohet se i ushtron të gjitha, vecanërisht përgjegjësitë e këtij të fundit”.

KAS rezulton gjithashtu ta ketë bazuar vendimin objekt padie gjithashtu në argumentin se:

“1.Rregullat e Kodit Zgjedhor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore kanë qëllim të garantojnë konkurrueshmërinë në zgjedhje, duke siguruar barazinë në garë midis partive politike,

koalicioneve dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Kjo do të thotë se qëllimi i rregullave nuk është në asnjë rast përjashtimi, por përfshirja dhe lehtësimi i kushteve për garë...

9. Ankuesi i përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri provoi me dokumentacionin dhe parashtrimet që paraqiti, se nuk e demonstroi dot vazhdimësinë e subjektit. Lëvizja e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të PDSH-së nisi dhe u zhvillua si lëvizje kundër establishmentit të Partisë, e cila synonte ndër të tjera shkarkimin para kohe të Kryetarit të Partisë. Proceset zgjedhore të iniciuara prej saj nuk janë njohur nga pjesa tjetër e partisë dhe janë kontestuar në rrugë statutores dhe ligjore. Aktet e forumeve të mbledhura nuk janë regjistruar dot në regjistrin e partive politike dhe konflikti është duke u zhvilluar brenda sistemit gjyqësor. Deri në momentin e shqyrtimit të ankesës, ankuesi i përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri nuk ka regjistruar në regjistrin e partive politike asnjë nga aktet e miratuara nga forumet e tij. Ndryshe nga ankuesi tjetër që përfaqësohet nga z. Indrit Sefa, ky ankues nuk ndodhet në situatën e mosazhurnimit të të dhënave në regjistrin e partive politike. Ai ndodhet në situatën e pamundësisë për akses në të dhënat e regjistrit për Partinë Demokratike, sepse nuk disponon mbi vendime gjyqësore që lejohet të regjistrohen dhe që mund t'i japin aksesin mbi të dhënat e Partisë. I pyetur nga KAS-i për këtë çështje, përfaqësuesi në seancë i ankuesit z. Ledio Nuraj pranoi se grupimi i tij nuk ka mundësi të regjistrojnë në regjistrin e partive politike asnjë nga aktet e miratuara nga ky grupim që nga data 11.12.2022 e deri në ditën e shqyrtimit të ankesës në KAS.

10. Mungesa e regjistrimit të akteve në regjistrin e partive politike i heq të drejtën këtij ankuesi që të identifikohet ligjërisht me Partinë Demokratike, për pasojë nuk e legjitimon për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023...

20. Mënyra sesi partitë politike zgjedhin të delegojnë tagrin e drejtimit të partisë tek një ose me shumë individë, në rastet kur drejtuesi i subjektit jep dorëheqjen apo ndërron jete, nuk lidhet domosdoshmërisht me depozitimin në gjykatë, pasi kjo është një procedurë që ligji e zgjedhor nuk e parashikon dhe për me tepër, rregullimi i brendshëm i partive politike nuk mund të përcaktohet nga KQZ apo organet e tjera shtetërore. Në çdo rast subjekti zgjedhor nuk mund të pengohet të marrë pjesë në zgjedhje, sa kohë që personi që ushtron detyrën e Kryetarit pranon të përmbushë këtë detyrimet formale të regjistrimit, përfshi edhe Deklaratën Solemne të vendosur me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, si një akt deklarativ i vullnetit të mirë për të zbatuar ligjin".

Në cilësinë e gjyqtarit të mbetur në pakicë vlerësoj se, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, për hir të garës, ka "garantuar" nëpërmjet vendimit objekt ankimi, konkureshmërinë në zgjedhje, duke bërë pjesë të saj, subjektin politik Partia Demokratike me kryetar të komanduar Z. Enkelejd Alibeaj, pavarësisht konfirmimit nga KAS, të faktit se:

- Partia Demokratike është ndarë në pjesë dhe se proceset zgjedhore të iniciuara nga njëra pjesë, nuk janë njohur nga pjesa tjetër e partisë;
- Deri në momentin e shqyrtimit të ankesës, as ankuesi i përfaqësuar nga Z. Ledio Nuraj dhe Z. Franci Nuri, as ankuesi i përfaqësuar nga Z. Indrit Sefa, nuk kishin regjistruar në regjistrin e partive politike, si aktet e miratuara nga forumet e rithemelimit, ashtu edhe aktet që konfirmonin drejtimin e Partisë Demokratike, nga Z. Enkelejd Alibeaj.

Rrjedhimisht KAS, bazuar në standarde të dyfishta, rezulton të ketë përjashtuar nga pjesëmarrja në garën zgjedhore, atë pjesë të Partisë Demokratike që ka mbështetur procesin zgjedhor të rithemelimit, edhe pse nga pikëpamja dokumentare e regjistrimit, problematikat rezultonin të njëjta me pjesën që nuk e kishte miratuar këtë proces.

Duke mos rënë dakord me sa më sipër, vlerësoj se, kërkespatria duhej pranuar pjesërisht, nëpërmjet shfuqizimit të Pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit Nr.27 Dt.16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Nëse subjekti politik Partia Demokratike, për shkak të problematikave ligjore, nuk mund të regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, kjo rrethanë vlerësoj se nuk e vë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve para përgjegjësisë për gjetje zgjidhjesh ekstraligjore, që shmangin këtë fakt dhe garantojnë pjesëmarrje në zgjedhje vetëm të njërës prej dy pjesëve në konflikt, brenda Partisë Demokratike.

**GJYQTARE
BLERONA HASA**